



RELACION TEKNIK

KARIERE PER SHFRYTEZIMIN E GELQEROREVE

(Sipas Vendimit nr. 912 datë.11.11.2015)

Subjekti: “ARTI”SHPK

**Vendodhja: Hammalloi ne fshatin Nivice, Komuna Lukove,
Himare**

Përgatiti për “GBA STUDIO”: Msc. Ing.Mjedisi Denisa KOLA

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Denisa Kola', is written over the printed name.

TIRANE 2017



A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Denisa Kola', is written over the stamp.

HYRJE

Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit te propozuar ne perdorimin e tokes, efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, emetimin e gazeve sere ne atmosfere, shkarkimet ne toke, uje, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social ekonomik ne punesimin lokal, permiresimin e infrastruktures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale, perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permisimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

-Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.

-Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.

-Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit minerar te prodhimit te mineralit ndertimor gurit gelqerore me kariere mbi mjedisin human.

-Analizen e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per reduktimine ndikimeve negative.

-Nxjerrjes ne dukje dhe vlersimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.

-Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Projekti tenton permiresimin e vlerave ekologjike e rikrijuese te territorit, gjate shfrytezimit te tije , si qender rekreative e social- kulturore.

Per kete problem u be mbikqyrja e terrenit ne te gjithë zonen, duke kryer vrojtime te ndryshme , si dhe te biodiversitetit.

Metoda me e pershtateshme per vleresimin e ndikimit ne mjedis u pranua ajo e liste – kontrollit, e cila vendos nga njera ane te gjitha burimet e mundeshme te ndikimeve dhe nga ana tjeter bartesit e ndikimeve , si dhe parashikimin e madhesise se ndikimit. Ne raport jepet statusi i territorit, korniza ligjore e tij, mjedisi biofizik, gjeologjia e rajonit, gjeologjia e zones, hidrogjeologjia dhe veçorite kryesore te morfologjise se rajonit . Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen. Termi mjedis dhe burime natyrore perdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qarte qe i perkufizon . Burimet natyrore i referohen burimeve te tokes, ujerave siperfaqesore dhe nentokesore , ajrit qe rrethon token, çdo gje qe rritet ne toke apo det si dhe burimet qe gjenden nentoke si psh mineralet. Mjedisi eshte me gjithperfshires, cdo gje qe na rrethon.

Thjesht duke perdorur burimet natyrore ne rrezikojme ne mbiperdorimin dhe shterimin e tyre. Shterimi i burimeve natyrore eshte nje nga problemet thelbesor te çrregullimit te mjedisit. Ne te perfshihet shterimi i ujit, mineraleve perfshire dhe lendet fosile si dhe shume burime te tjera. Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqerohet edhe me impakt ne mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor.

Kemi dy tipe te impaktit mjedisor

- Shterimi i burimeve

- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve

natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne.

Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithë. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore. Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytet kryesore , ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

a) Qellimi i Projektit

“ARTI” sh.p.k ka per qellim nxjerrjen dhe perpunimin e Gurit Gelqeror.Kjo kerkon ti ofroj tregut shqiptar produkte cilesore me cmime te arsyeshme .Projekti i paraqitur nga shoqeria ka per qellim te ofroje sherbime te klientela, si dhe te pasqyroje ndikimet e mundshme ne shendet dhe mjedis gjate ketij aktiviteti.Nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike organizative per zbutjen e ndikimeve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit.

b) Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne hartën topografike siperfaqja e tokes se kerkuar , kufijt e siperfaqes se kerkuar , te dhenat per perdorimin ekzistues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve.

Vendi i ushtrimit te ketij aktiviteti ndodhet ne Hamalloi, ne fsahtin Nivice, komuna Lokove, Himare.



Koordinat sipas lejes minerare

X	Y
4417400	4415694
4417640	4415500
4417730	4415640
4417470	4415830



Harta e zones ne shfrytezim nga leja minerare

c) Gjeografia e topografia e zones

Nga veriu qyteti Sarandë kufizohet me Kakomenë dhe Hamalloin, nga juglindja me Lëkurësin (fshati shpërngulur qysh në kohën e Luftës së Lëkurësit, më 1878, sot topogërmadhë), nga lindja me Gjashtën dhe nga perëndimi me Detin Jon. Saranda ka një klimë tipike mesdhetare. Saranda ka numrin më të lartë të ditëve me diell edhe në Evropë, mbi 270 ditë. Pasuritë natyrore. Zona e Sarandës karakterizohet nga një numër i madh habitatesh natyrore, gjysmënatyrore dhe artificiale. Ka një bimësi të larmishme tipike mesdhetare. Zona njihet për prodhimin e agrumeve dhe ullirit, ndërkohë që pemët frutore zënë rreth 30 për qind të sipërfaqes. Pasurisë bimore të Sarandës i shtohet edhe bimësia ujore e detit Jon. Në thellësitë e Jonit nuk mungojnë edhe koralet. Zona u afron vizitorëve vendas dhe të huaj pamje spektakolare të ujërave blu. Zona e Sarandës ka një botë shtazore të pasur, si derri i egër, lepuri, çakalli, dhelpra, ujku, sorkadhja, thëllëza, rosa etj. Disa rezervate, si ai i pyllit të Butrintit, Stillos, Corrajt, Muzinës, janë një vend gjuetie mjaft i përshtatshëm për amatorët e këtij sporti. Edhe pasuria ujore dhe shtazore e detit Jon është e shumëllojshme. Delfinët janë miq të qytetit, duke u afruar brigjeve të Sarandës. Një breshkë e llojit Careta-Careta është parë së fundmi në Butrint. Ujërat detare janë jashtëzakonisht të kthjellëta dhe me ngjyrë blu. E gjithë zona ofron habitate të çmuara me peshq dhe lloje të tjera kafshësh detare. Bregu i detit Jon është në shumë zona ende i virgjër dhe jashtëzakonisht i bukur. Në këtë zonë përfshihet laguna tipike mesdhetare e Butrintit, rreth 1600 ha. Laguna është e pasur me bimësi që shërben si ushqim për llojet e shumtë të peshqve. Laguna është gjithashtu vend ndalese për mijëra zogj ujorë dimërorë dhe shtegtarë. Për shkak të rritjes së shpejtë urbane të Sarandës, pas rënies së komunizmit, ka lagje dhe toponime të reja.

Te dhena hidrogeologjike

Ne aspektin hidrogeologjik ky shesh nuk karakterizohet nga ujembajtje e vazhueshme, për vete faktin se sheshi është në kuotë me të lartë se ajo e nivelit të detit. Tendencat e dinamikës së ujërave është nga lindje në perëndim, por levizja është shumë e ngadalte. Në rast hapje themelesh apo kanalesh ujembajtja do të jetë e vogël. Ardhja e ujërave nga lindja drejt perëndimit do të shtohet.

Te dhenat sizmike

Studimet sizmoteknike kanë të bëjnë me të dhenat për termetet, ato lidhin sizmicitetin me shkeputjet aktive. Kushtet e vendosjes strukturore dhe tektonike të ndodhjes së termeteve janë përfunduar kryesisht nga analiza përgjithëse e të dhënave nga gjeologjia, gjeofizika dhe dukuritë sizmologjike. Dihet se aktiviteti i sotëm terretor lidhet ngushtë me strukturën e sotme gjeologjike, me strukturën neotektonike të vendit të tone. Është tashmë e mirënjohur dhe e pranuar nga shumica e studiuesve se shkeputjet tektonike janë burimet e klirimit të energjisë sizmike. Terreti ndodh atje dhe atëherë ku edhe sforcimet e lindura deformimet tektonike, tejkalojnë kufirin e fortësisë së lëndës përgjatë ketyre shkeputjeve.

d) Pershkrim i procesit ndertimore dhe teknologjike, perfshire kapacitetet prodhuese perpunuese , sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit

Procesi teknologjik i prodhimit te gurit gelqerore ne kariere eshte i thjesht. Shfrytezimi do te behet nga larte poshte nga shkalla e pare +620 deri +510, duke u ulur cdo 10m deri ne shkallen fundore . Coptimi gurit gelqerore do te behet me lende plasese te vendosura ne bira sonde. Sonda e shpimit te birave vendoset ne sheshin e siperm te shkalles, per lartesi shkalle 10m birat do te shpohen 11, me diameter 89mm, largesia midis birave 4m dhe largesia midis rreshtave 3.5m Ngarkimi gurit gelqerore ne sheshin e shkalleve do te behet me eskavator me zinxhira me madhesi kove $2m^3$, eskavatori vendoset ne sheshin e shkalles se shfrytezimit. Transporti deri ne impjantin e thyerje fraksionimit do te behet me automjete me kapacitet transporti $16m^3$.

Percaktimi kapacitetit prodhues

Prodhimi i mineralit ndertimor gure gelqerore me kariere u projektua duke patur ne konsiderat keto kerkesa: 1-Sasin e pergjithshme te rezervave te vendburimit te mundshme per shfrytezim. 2- Kushtet tekniko-minerare te vendburimit . 3- Kerkesat e investitorit per mineral ndertimor gurit gelqerore. Ne zbatim te aktit te miratimit te tenderit subjekti do te kete prodhim vjetor te gurit gelqerore do te jete \deri $30\ 000\ m^3/vit$.

-Sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit

- Sasite e lendeve te para

Ne teknologjine e shfrytezimit te gurit gelqerore me kariere nuk perdoren lende te para ne sherbim te aktivitetit, prandaj nuk do ta trajtojme. Theksojme se ne kariere nuk do te perdoren lende te demshme (toksike) qe po te shkarkohen ne uje, ajer dhe toke ndotin ambientin dhe demtojne floren dhe faunen e zones. Makinerit qe do te perdoren ne kariere jane me motor dizel, ato punojne me nafte dhe lubrifikohen me vajra. Nga punonjesit e karieres kujdes i vecant do te tregohet per grumbullimin e vajrave te djegura, ato do te grumbullohen dhe do te tregtohen tek subjektet qe perpunojne vajrat e djegura duke i ricikluar. Gjithashtu punonjesit do te jene instruktuar si te veprojne ne rast se ndodhin rrjedhje aksidentale te vajrave nga sotokarteri i makinave ne rast avarish. Ne keto raste gjith materiali ndotur do te mblidhet dhe do te trasportohet ne sheshet e caktuara nga pushteti vendor.

- Produktet perfundimtare te projektit

Produkti perfundimtar i aktivitetit te shfrytezimit te mineralit te gurit gelqerore ne vendburimin Kanine objekti minerar 211/4eshte prodhim mineral gure gelqerorei me kariere.

Prodhimi gurit gelqerore do te realizohet me lende plasese te vendosura ne bira sonde. Gure gelqerorei i prodhuar ne shshet e shkalleve te karieres do te ngarkohet dhe do te transportohet ne linjen e perpunimit te inerteve por nuk perjashtohet mundesia e eksportit te ketij minerali ne rast te gjetjes se tregut.

Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrike, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja

Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik

Vendburimin e projektuar per shfrytezim gure gelqerorei me kariere ne nje pjese te vogel te siperfaqes pasi jo e gjithë siperfaqja e publikuar do te preket nga shfrytezimi pasi vetem nje pjese e vogel ka rezerva minerale gure gelqerorei rreth 141300 m² Subjekti ne marreveshje me OSHEE ne zbatim te legjislacionit Shqiptar do te furnizohet me energji elektrike nga kjo linje duke nderhyre me nje lidhje te re, do te ndertoje kabine transformimi dhe panel shperndarje te energjise per te furnizuar objektet e sherbimit, ndricimin e karieres, pasi aty do te kete mjete motorike te cilat kane nevoje per naten ., etj. Ne keto kushte mund te themi se infrastruktura per lidhjen me rrjetin elektrik eshte e ngritur, ekzistuese.

Furnizimin me uje

Ne teknologjine e prodhimit te gurit gelqerore me kariere nuk perdoret uji. Uji do te perdoret ne periudhe te thate per lagien e rrugeve te levizjes se mjeteve te transportit, lagien e ngarkesave te gurit gelqerore ne mjetet e transportit, dhe per sherbime vetiake nga personeli sherbimit ne kariere. Sasi e ujit do te jete minimale rreth 10m³ ne dite. Uje ne fazen e pare do te sigurohet me depozit qe do te furnizohet me autobot qe ka ne perdorim subjekti, ne nje faze te dyte do te ndertohet linje furnizimi me uji .

Shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve

Ne procese teknologjike te shfrytezimit te gurit gelqerore me kariere nuk do te perdoret uji. Aktiviteti prodhon mineral gure gelqerorei. Ne dite me rreshje ne kariere nuk punohet nje nder arsytet eshte se gure gelqerorei me prezence uji pasi materiali qe shoqeron gure gelqerorein eshte argjile ecila perzihet me gure gelqerorein dhe e varferon ate. Uji do perdoret per lagien e territorit per paksimin e pluhurave gjate procesit te nxjerrjes se gurit gelqerore dhe do sigurohet permes depozitave nga shoqeria. Ujrat e ndotura nga pluhurat e krijuara nga gure gelqerorei do te depozitohen ne vaskat e ndertuara ne sheshin e karieres . Praktikisht do te ndertohen dy vaska me keto parametra: gjatesi 6m, gjeresi 3m dhe thellesi 2m. Uji i ndotur do te shkarkohet ne nje vaske dhe pasi te mbushet me llumra, ujrat kalojne ne vasken tjetere. Ujrat largohen nga vaska pasi te jene ngurtesuar dhe depozitohen ne sheshin e caktuar nga pushteti vendor ose ne sheshin e karieres ne nje zone te percaktuar. Vaskat rrethohen me lartesi deri 2m me rrjet metalike te qendrueshme per tu mbrojtur nga renia e njerzve ne to dhe per menjanuar aksidentet ne pune. Ujrat e pastra pas vaskave do te

riperdoren ose do te shkarkohen ne kolektorin kryesor te ujrave. Gjithashtu mbetjet e krijuara ne kariere nga veprimtaria humane e punonjesve ose nga proceset e punes do te transportohen ne sheshin e depozitimit te miratuar nga pushteti vendor ose ne teritorin e karrieres dhe do te riciklohen ne mbyllje te aktivitetit per rehabilitimin e karrieres.

Rruget ekzistuese te aksesit apo nevoja per hapje te rrugeve te reja

Infrastruktura rrugore e zones se projektuar eshte e ndertuar. Zona qe kerkohet per tu shfrytezuar eshte mbi karieren e shfrytezuar vite me pare . Nga kjo rruge do te hapet nje rruge per te shkuar ne nivelin e siperm ne kuoten +620m. Hapja e vendburimit do te behet nga rruga ekzistuese qe pershkron ne pjesen veriore karrieren, pra nuk do te jete e nevojshme hapja e rrugeve te reja. Per shfrytezimin e gurit gelqerore ne kete objekt nuk do te jete e nevojshme te hapen rruge te reja

Zhurmat

Burimi i akumuluar i zhurmave nga puna e njekoheshme e makinerive ne distance 7 m nga to, eshte **180 dB**. Duke mare parasysh shprehjen e nivelit te intensitetit akustik te nje zhurme me relacinin me poshtem:

$$L = 10 \lg (I_1/I_0) \text{ ku}$$

Ku:

L - Niveli akustik i zhurmes te marre ne konsiderate.

I₁ - Intensiteti akustik izhurmave te kumuluar.

I₀ - Intensiteti akustik i references.

Vleresojme se niveli akustik i zhurmes ne rruge eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te, praktikisht ai eshte 40-50 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal. Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 200-2000 Hz, e cila e shte e pranueshme nga veshi i njeriut. Gjate fazes se zbatimit te projektit nuk do te kete emetime te gazrave, lengjeve, mbetje toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin per rreth duke perfshire te gjitha llojet e bimeve dhe gjallesave te ndryshme. Teknologjia e ushtrimit te aktivitetit nuk parashikon perdorimin e ujit. Ujrat e reshjeve do te dekantohen ne gropa brenda zones pastaj rrjedhja e metejshe e tyre do te behet ne perputhje me rrjedhen natyrale te tyre.

- e) **Programi per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatja e planifikuar e funksionimit te projektit, kohen e mundeshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe faza e planifikuar per rehabilitimin e siperfaqes pas mbarimit te funksionimit te projektit**

Punimet e ndertimit per venien ne shfrytezim te karieres jane: - Ndertimi brenda teritorit te karieres te nje rruge automobilistike nga kuota +510m, qe perkon me shkallen fundore te karieres deri ne kuoten +620m . -Ndertimi vaskave te depozitimit te llumrave. -Ndertimi objekteve ndihmese te sherbimit. -Ndertimi i linjes se furnizimit me energji elektrike te objektit dhe montimit te trasformatorit shtyllore dhe panelin shperndares.

Programi per ndertimin e punive ne kariere, kohezgjatja e ndertimit Punimet e ndertimit do te zgjasin nje vit, ato do te realizohen ne vitin e pare te lejes minerare

Projekti ndertimor per hapjen e karieres - Ka per qellim lidhjen e fronteve te prodhimit te gurit gelqerore (te shesheve te shkalleve) me rrugen nacionale te transportit. Hapja e vendburimit do te behet nga rruga ekzistuese qe pershkon ne pjesen veriore karrieren. Hapja e vendburimit eshte projektuar ne menyre qe shfrytezimi i gurit gelqerore ne kariere te behet nga lart poshte. Per hartimin e projektit te ndertimit te rruges automobilistike ne kariere jane marre ne konsiderat parametrat si vijon: - Lartesine e projektuar te shkalleve te karieres - Elementet e shtrirjes dhe renies se depozitimeve te gurit gelqerore ne zonen e projektuar. - Siperfaqja e zones se projektuar. - Vetite fiziko – mekanike te shkembinjve - Kushtet klimaterike dhe hidrogjeologjike te rajonit ku kryhet aktiviteti. - Relievi - Lloji transportit qe parapelqen investitori, makinerit e shpimit te birave me sonde dhe ngarkimit te prodhimit ne sheshin e shkalleve. - Sasia e rezervave te vendburimit qe do te aktivizohen. - Prodhimi nder vite i projektuar. Duke ju referuar faktoreve te mesiperm hapja e vendburimit do te behet me Gjysem trashe kapitale te thjeshte te vendosur brenda kufive te fushes minerare. Gjysem trashea kapitale eshte projektuar te ndertohet me gjysem seksion. Ky punim do te zhduket me perfundimin e shfrytezimit te vendburimit ne karieren e projektuar.

Percaktimi i jetegjatesise se karieres

Duhet te sqarojme se rezervat e publikuara ne faqen e MEI prej 2 milion ton mineral gure gelqerore nuk rezultojne pasi pjesa me e madhe e siperfaqes eshte argjile dhe toke buke. Nga te dhenat e Studimit tekniko ekonomik dhe nga llogaritjet e kryera rezultojne rreth 3 613 095m³ Duke patur parasyshe qe ne njoftimin e fituesit te konkurimit rezulton se shifra ne prodhimin vjetor rezulton 30 000m³/vitdhe jeta e karieres rezulton te jete afersisht 25 vjet duke marre parasyshe edhe investimet qe do te kryhen.

f) lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji)

Per ndertimin e rruges se hapjes se karieres, ndertimin vaskave te depozitimit te llumrave, ndertimin e linjes elektrike dhe shfrytezimit te gurit gelqerore ne kariere do te perdoren makinerit, si: Sonde shpimi, eskavator me zinxhira, kamione transporti me motora dizel qe punojne me karburant (Dizel). Karburanti do te furnizohet nga subjekte te licencuara per import, ruajtje dhe tregtim te karburanteve ne republiken e Shqiperise. Ndersa per mbrojtjen nga pluhuri, per nevoja vetiake dhe nga punonjesit, mbrojtjen nga zjarri dhe sherbime te tjera do te perdoret uje. Uje ne fazen e pare do te sigurohet me rezervuar qe do te furnizohet me autobot, ne fazen e dyte me rritjen e prodhimit do te ndertohet me miratim te ujesjellesit linje

furnizimi me uje. Ndertimet e objekteve te sherbimit do te behet me materiale te lehta sanduici qe do te merren te gateshme nga subjekte te specializuara. Sasia 3 kontoniere Coptimi gurit gelqerore do te behet me forcen mekanike te çekiçit dhe lende plasese dhe me ne bira te shkurtera.

Lendet e para ndihmese qe do te perdoren ne kariere jane:

- Naftë dhe Vajra lubrifikant
- Uje
- Energjia elektrike per ndricim ne karieren
- Energji elektrike per impjantin e thyerje fraksionimit te gurit gelqerore
- Panele Sanduici
- Lende plasese te perdorimit civil dhe materiale plasese ne dite

j)Informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate persa i takon perzgjedhjes se vendodhjes se projektit dhe teknologjise qe do perdoret

Theksojme per organet vendim marrese, se mundesia e alternativave te marra ne konsiderat per perzgjedhjen e vendodhjes se projektit nga subjektet minerare ne teresi jane ne nivelin zero per keto arsye: - Zona minerare dhe objekti percaktohet nga MEI me propozim te AKBN dhe shpallet ne planin tre vjecar dhe nji vjecar te Ministrise. - Investitoret qe kryejne aktivite minerare jane para nje fakti te kryer per pjesmarrje ne tender te zonave minerarte te shpallura per konkurim. Projekti hapjes se karieres ka per qellim lidhjen e fronteve te prodhimit te gurit gelqerore (te shesheve te shkalleve) me rrugen nacionale te transportit. Hapja e vendburimit do te behet nga rruga ekzistuese qe pershkon ne pjesen veriore karieren. Hapja e vendburimit eshte projektuar ne menyre qe shfrytezimi i gurit gelqerore ne kariere te behet nga lart poshte. Teknologjia qe do perdoret per shfrytezimin e gurit gelqerore eshte e thjeshte. Rrezimi gurit gelqerore ne sheshet e shkalleve te shfrytezimit do te behet me lende plasese te perdorimit civil te vendosura ne bira sonde me thellesi 11m per lartesi shkalle 10m Ngarkimi prodhimit ne sheshin e shkalleve te shfrytezimit do te behet me eskavato me zinxhira, me kapacitet kove $2m^3$ Transporti prodhimit deri ne destinacion do te behet me atomjete vetshkarkuese $16m^3$.

k) Perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshme , energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre

Ky aktivitet eshte aktivitet shfrytezimi i cili konsiston ne nxjerrjen e gurit gelqerore pra nuk perdor lende te para por siguron lende te pare per industrine e ndertimit. Uji perdoret vetem ne rastet per lagien e territorit ne menyre qe te mos kete krijim te pluhurave gjate veprimtarise sidomos ne kohe te thate dhe me ere, kjo sasi uji sigurohet permes depozitave te ujit qe shoqeria siguron per kete qellim. Lendet djegese qe perdorin mjetet e transportit sigurohet ne pikat e furnizimit me karburant. Lendet e para ndihmese te konsumuara per prodhim gure gelqerorei te projektruar $1136.4m^3/dite$ jane:

- Nafta = $380m^3/dite \times 0.33litra/m^3 = 125.4litra$ naftë ne dite -Vajrat lubrifikante = $380m^3/dite \times 0.013litra/m^3 = 5$ litra ne dite -Uje = $50m^3$ per te lagur nje siperfaqe $5000m^2$ - Energjia elektrike per ndricim ne karieren = 3kw

l)Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit , si ndertim i kampeve apo rezidencave etj.

Zhvillimi i projektit nuk kerkon ndertimin e kampeve per qendrimin e punetoreve gjate kohes se shfrytezimit sepse numri i te punesuarve nuk eshte aq i madh sa per te ndertuar keto kampe per fjetje apo mensa sherbimi dhe gjithashtu te punesuarit jane nga zona perreth vendburimit qe do te shfrytezohet dhe punojne vetem me nje nderese ne dite. Vepra inxhinierike qe do te ndertohen ose zgjerohen per shfrytezimin e gurit gelqerore nuk do te kete. Teknologjia e shfrytezimit te gurit gelqerore eshte e thjeshte konsiston ne coptimin e tyre, ngarkimin dhe transportindrejt destinacionit te kerkuar. Shfrytezimi do te behet ne siperfaqe me kariere.

m)Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin/licensimin e projektit

Subjekti ne fjale nuk disponon Leje Mjedisi tani po ndjek procedurat per tu paisur me te si ne kete rast qe subjekti ARTI SHPK kerkon te paiset me Deklarate Mjedisore per shfrytezimin e gurit gelqerore pasi eshte paisur me Leje Minerare te leshuar ne date 03.09.2012 deri ne 03.07.2022.

